



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:099633

Datë: 23.02.2024

Numri i dokumentit: 05367373

C.nr.660/2018

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridiko kontestimore sipas padisë së paditësit H.Ç., nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.D.N. nga Prizreni, kundër të paditurit N.K. nga Prizreni, me objekt të padisë vërtetimin e të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 3.100 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datë **20 Shkurt 2023**, mori këtë:

A K T G J Y K I M
-Në bazë të pohimit-

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit H.Ç. nga fshati Komuna e Prizrenit.

II. VËRTETOHET se paditësi H.Ç. nga fshati Komuna e Prizrenit, në bazë të shitblerjes është pronar i paluajtshmeris , e cila evidentohet si ngastër kadastrale nr. P-71813068-.... ZK Prizren, në sipërfaqe prej 168 m2, ZK-Prizren, e regjistruar si pronësi në emër të të paditurit , gjë që detyrohet i padituri N.K. nga Prizreni, pranojnë këtë fakt dhe të lejojnë paditësin që të regjistrohet si bashkëpronar i kësaj ngastre në regjistrin e paluajtshmërive të Komunës së Prizrenit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi H.Ç. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.D.N. nga Prizreni, ka parashtruar padi pranë kësaj gjykate me date 10.05.2018, kundër të paditurit N.K. nga Prizreni, me objekt të padisë vërtetimin e të drejtës së pronësisë, , në lidhje me paluajtshmerinë të përshkruar në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në seancën e shqyrtimit përgatitorë dhe atë kryesore të mbajtur me datë 20.02.2024, i padituri N.K. nga Prizreni, deklaroi se **në tërësi e pranon kërkesëpadinë** e paditësit, (pasi që ngastrën kadastrale e cekura në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi sipas i padituri ia ka shitur paditësit përmes kontratës interne qysh në vitin 2012, ndërsa paditësi e ka paguar në tërësi çmimin dhe është në posedim të kësaj ngastre nga i njëjti vit) dhe i propozoj gjykatës që të merr aktgjykim në bazë të pohimit.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 148 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (Ligji Nr.03/L-006), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që erdhi në përfundim se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me parag.1 të nenit 148 të LPK-së. Ndërsa në anën tjetër gjykata nuk gjeti ndonjë pengesë ligjore të paraparë me parag.2 të nenit të cekur më lartë, të cilat do të ndikonin në mos marrjen e këtij aktgjykimi. Në shkresat e lëndës gjendet prova të mjaftueshme të cilat e vërtetojnë bazën juridike të kërkesëpadisë, si dhe legjitimitetin aktiv dhe pasiv të palëve, përfshirë këtu edhe ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë D.B. të datës 25.01.2024 (e marr pas daljes së gjykatës në vend), në të cilën konstatohet gjendja faktike dhe juridike ngastrës e cila është objekt shqyrtimi.

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi konfom nenin 450 të LPK-së, meqenëse asnjëra prej palëve ndërgjyqëse nuk i kërkoi të njëjtat.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.660/2018, datë 20 Shkurt 2024

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate. Bazuar në nenin 181.2 të LPK-së, ky aktgjykim mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkakut se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikim të dhunës apo mashtrimit.